



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-23-8265-1-3-6, numër të brendshëm 632-23-123-136 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-19026, për shkak të mos-përbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: "Ismaili Group" SH.P.K., Ndërmarrja e Re Fabrika e Amortizatoreve, 21 Prishtinë, me numër unik 811975054, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 18.09.2024, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës

Neni 28, paragrafi 28.1 i KPK përcakton se "Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 22.09.2023, me numër identifikues: 632-23-8265-1-3-6, numër të brendshëm 632-23-123-136 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-19026, me titull "Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestren e Sporteve", në mes të Komunës së Gjakovës dhe Furnizuesit "Ismaili Group" SH.P.K., me seli në Prishtinë, do të ndërpritet me date 19.09.2024.

Kontrata do të ndërpritet duke u bazuar në nenin 28, paragrafi 28.1 nën: a, b, dhe c, të Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Me datë 27.09.2023, ju është lëshuar urdhëresa e parë me shkrim për fillimin e punimeve, pas kësaj urdhëresat e datave: 18.10.2023, 17.01.2024, 19.03.2024 dhe 06.09.2024 të cilave urdhëresa ju nuk iu përgjigjet asnjëherë.

Për mos realizimin e furnizimeve konformë kushteve të kontratës jeni të informuar disa here radhazi përmes e-maileve të datës 27.09.2024, 18.10.2023, 17.01.2024, 19.03.2024 dhe 06.09.2024, të dërguara nga Menaxheri i Kontratës.

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim të dinamikës për furnizimet, duke u treguar i pa përgjegjshëm për detyrimet që ju ngarkon kontrata e sipërpërmendur.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 19.09.2024, do të ndërmarrim të gjitha veprimet konformë kushteve të kontratës.

Shkresës i bashkëngjiten të gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit të kontratës.

Me respekt,


Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	16.09.2024
PËR/ZA/TO:	Zyra e Prokurimit, z. Faton Gutaj, znj. Venera Shtaloja
CC:	znj. Adea Roka, drejtor i DKRS U. D. z. Labinot Efendiu, Udheheqës i Sektorit për Sport Kryetari i Komunës – z. Ardian Gjini
NGA/OD/FROM	Bernard Zeka , Menaxher i Kontratës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndërprerje të kontratës "Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestrën e sporteve" nr. i kontratës 632-23-8265-1-3-6/C798

Të nderuar ,

Lidhur me Kontratën me Titull "Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestrën e sporteve" nr. i kontratës 632-23-8265-1-3-6/C798, e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe "ISMAILI GROUP SHPK, Ndermarrja e Re Fabrika e Amortizatorve, 21" me nr. unik 811975054, e përfaqësuar nga z. Labinot Ismaili Prishtinë, më datë 22.09.2023, ju njoftojmë se OE nuk i ka respektuar kushtet e kontratës dhe si pasoj Rekomandoj Ndërprerjen e kontratës bazuar në :

Ju njoftojmë se nga ana e Menaxherit të projektit janë lëshuar këto Njoftime, kërkesa, dhe urdhëresa përmes emailit zyrtar dhe telefonit (Neni 6):

- 27.09.2023 – Urdhëresa e parë për fillimin e punimeve (email)
- 18.10.2023 - Urdhërese e dytë përmes (email)
- 17.01.2024 - Urdhëresa e tretë (përmes telefonit)
Përmes telefonit nga OE do të siguroj pajisjet dhe do të filloj me punimet të cilat do t'i përfundoj për 7 ditë. Mirëpo nuk ka filluar as nuk na ka informuar për mos fillimin e punimeve.
- 01/19.03.2024 - Urdhëresa e tretë (përmes telefonit)
- Përmes telefonit OE-së - Rekomandim për ndërprerje të kontratës.
- 06.09.2024 - Urdhëresa e katërt (përmes emailit zyrtar dhe prokurorimit)

Pas këtyre kërkesave, njoftimeve dhe Urdhëresave, Operatori Ekonomik nuk është i gatshëm për përfundimin e punimeve sipas kontratës edhe pse vazhdimisht është kontaktuar qoftë përmes emaili ose edhe telefonit i njëjti ende nuk ka filluar punimet, andaj kërkoj nga ana e Juaj fillimin e procedurave për ndërprerje të kontratës.

Me respekt! *Bernard Zeka*

Bashkangjitur kërkesat, njoftimet dhe urdhëresat.

Reply Reply All Forward



Bernard Zeka

Shant Kijaj; Fean Gula; Elvane Qanagja; shantgroup@hotmail.com

Njoftim për fillimin e procedurave për ndërprerje të Kontratës

Përsëritet,

Unë menaxheri i kontratës me titull "Furnizimi dhe montimi i rrezeve, perdeve dhe detyrë emergjente në Palestrën e Sporteve" Nr. i Kontratës 632-23-8263-1-3-6/C798, lidhur me operatorin e kontraktuar të kontratës së lartë përmendur "Ismaili Group" SH.P.K, adresa: Ndërmarrja e Re Fabrika e Amortizatorëve, 21, Prishtinë. Numri i Unik: 811975054, kam rekomanduar që të zhvillohen procedurat për ndërprerje të kontratës, me arsyetimin se pas disa urdhërësive dhe njoftimeve të bëra i njëjti nuk ka vazhduar të kryej punimet e mbetura sipas kontratës së lartpërmendur kështu që ka kaluar çdo afat kohor.

Ashtu siç dhe biseduam në takim të mëtejshëm ju njoftoj që në afatin kohor prej 5 (pesë) ditësh fillojnë procedurat për ndërprerjen e kontratës së lartë përmendur.

Me Respekt!
Bernard Zeka
Menaxher i Kontratës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Data:	27 / 09 / 2023
Referencë	10 – Zyr.
Për:	Ismaili Group SH.P.K., Ndermarrja e Re Fabrika e Amortizatorëve, 21, Prishtinë, me nr. unik 811975054, e përfaqësuar nga z. Labinot Ismaili
Nga:	Menaxher i Kontratës – Bernard Zeka
Cc:	Zyra e Prokurimit – Faton Gutaj Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – Adea Roka
Tema:	Urdhëresë për fillimin e punimeve

Urdhëresë për fillimin e punimeve – “Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestrën e Sporteve”, me numër identifikues 632-23-8265-136 dhe numër i brendshëm 632-23-123-136.

Në bazë të kontratës me numër të kontratës 632-23-8265-1-3-6/C798, e lidhur me datë 22.09.2023, në Gjakovë, lëshon këtë:

URDHËRESË

Për Ismaili Group SH.P.K., Ndermarrja e Re Fabrika e Amortizatorëve, 21, Prishtinë, me nr. unik 811975054, e përfaqësuar nga z. Labinot Ismaili, i cili urdhërohet që të fillojë punët sa më parë, në kontratën “Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestrën e Sporteve” në Gjakovë.

Ismaili Group SH.P.K., Ndermarrja e Re Fabrika e Amortizatorëve, 21, Prishtinë, me nr. unik 811975054, e përfaqësuar nga z. Labinot Ismaili, është kontraktues i komunës së Gjakovës për kontratën me titull “Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestrën e Sporteve” në Gjakovë me numër të kontratës 632-23-8265-1-3-6/C798, numër identifikues 632-23-8265-136 dhe numër i brendshëm 632-23-123-136.

Punimet të fillojnë në afatin sa më të shkurtër kohor, ndërsa punë kryesi duhet ti kryen punimet sipas kushteve të caktuara në kontratë.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591

telekomunikacioni / telekomunikacioni



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Autoriteti Kontraktues: Komuna e Gjakovës

Adresa: Rr. "UÇK", P.N

Data: 18.10.2023

Operatori Ekonomik: Ismaili Group SH.P.K.,

Adresa: Ndermarja e Re Fabrika e
Amortizatorëve, 21, Prishtinë

Numri i Unik: 811975054

Duke u bazuar në Nenin 70, paragrafin 13 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues (AK) lëshon këtë:

LETËR PËR FILLIMIN E PUNËVE

Titulli i Kontratës:

Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestren e Sporteve

Data e nënshkrimit të kontratës: 22.09.2023

Numri i Prokurimit: Nr. Identifikues 632-23-8265-1-3-6, Nr. i Brendshëm 632-23-123-136

Menaxheri i Kontratës: 632-23-8265-1-3-6/C798

Përmes kësaj Letre të Fillimit të Punëve, Menaxheri për Menaxhim të kontratës "Furnizimi dhe montimi i rrjetave, perdeve dhe dyerve emergjente në Palestren e Sporteve", urdhëron Operatorin Ekonomik: Ismaili Group SH.P.K. që në datë 19.10.2023, të fillojë me zbatimin e punëve sipas Kontratës (Kushteve të Veçanta – KVK dhe Kushteve të Përgjithshme të Kontratës – KPK), dokumentacionit investivo-teknik dhe tërë shkresave dhe urdhërësive të lëshuara apo që do të lëshohen nga Autoriteti Kontraktues. Operatori Ekonomik obligohet që të gjitha punët e specifikuara sipas kësaj kontrate, KVK dhe KPK si dhe urdhërësive dhe shkresave që do të lëshohen nga Autoriteti Kontraktues, duhet ti përfundojë më së largu brenda 30 ditëve, pas marrjes së urdhërësive nga projekt menaxheri.

Menaxheri i Kontratës:

Bernard Zeka

Nënshkrimi:

Bernard Zeka

Data: 18.10.2023

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Postal address: Nën Teutal – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591

kk.rks-gov.net/gjakove/

Fw: Urdhëresa për fillimin e punimeve



Bernard Zeka

Mon 12/10/2023, 11:05

tsmarigroupshpk@gmail.com <tsmarigroupshpk@gmail.com>

Send

Flag for follow up. Completed on 29 August 2024.



Urdhëresa për fillimin e ...
109 KB

8 files with attachments (203 KB) - Download

Përshëndetje,

Ju njoftoj që sipas urdhëresës për fillimin e punimeve të kontratës me titull "Furnizimi dhe montimi i rrjetave, porçeve dhe dyerve emergjente në palestren e Sporteve" nuk është ndërmarr asnjë iniciativë apo prezantim për fillimin e punimeve sipas afatit të paraparë.

Andaj si menaxher i kontratës kërkoj që deri më datë 17.11.2023 të paraqiteni dhe të filloni menjëherë punët sipas kontratës së lamë përmendur, në të kundërt jemi të obliguar që për mos respektimin e urdhëresës për fillimin e punimeve të ndërmarrim masat në bazë të ligjeve në fuqi.

From: Bernard Zeka
Sent: 18 October 2023 13:45
To: tsmarigroupshpk@gmail.com
Cc: Flirnik Ceka; Fabon Gulaj
Subject: Urdhëresa për fillimin e punimeve

Përshëndetje,

Ju lutem qeni të bashkangjitur Urdhëresën për fillimin e punimeve, të cilat duhen të fillojnë me datën 19.10.2023.

Më Respekt!

History



Tuesday, 19 March



14:20

 Outgoing call/Mobile/3 mins 24 secs

Friday, 15 March



13:26

 Outgoing call/Mobile

Friday, 1 March



13:56

 Outgoing call/Mobile/5 mins 34 secs

Wednesday, 17 January



11:41

 Incoming call/Mobile/2 mins 34 secs